



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA



AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY

Nr. Prot.: 36/12 Data: 05.07.2012
Br. Prot.: _____ Datum: _____
Prot. No.: _____ Date: _____

PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 36/12
Datë: 05.07.2012

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2011, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

VENDIM

Mbi ndarjen e kualifikimeve nga sektori i Makinerisë

- I. Aprovohet ndarja e kualifikimeve prej kualifikimit Instalues i ujësjellsit dhe ngrohjes qëndrore në:
 1. Instalues i ujësjellsit dhe kanalizimit;
 2. Instalues i ngrohjes qëndrore.
- II. Vendimi hyn në fuqi më datën e nënshkrimit të tij.
- III. Vendimi të gjitha palëve të interesit

Arsyetim

Standardet profesionale janë të ndara për secilin kualifikim instalues i ujësjellsit dhe kanalizimit edhe instalues i ngrohjes qëndrore. Konsultimet e realizuara me ekspert të fushës së makinerisë kanë dhënë vlerësimin e tyre se kualifikimi instalues i ujësjellsit dhe ngrohjes qëndrore duhet të ndahet si kualifikime të ndara, në Instalues i ujësjellsit dhe kanalizimit edhe Instalues i ngrohjes qëndrore.

Duke marrë parasysh që në Udhëzimin Administrativ të miratuar në shkurt të 01/2011 nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nuk është përcaktuar kjo ndarje e kualifikimeve sipas kriteve.

Kryetari i KD të AKK-së
Ragip Gjoshi

